



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
NJËSIA BAZË (DEPARTAMENTI) I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT
JAVA 01
29 dhjetor 2025 – 04 janar 2026

Për këtë javë, kanë raportuar 36 Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) ose 100% (=36/36) e tyre.

Tabela 1. Plotësimi i formularit ALERT sipas çdo NJVKSH

Perqindja e plotesueshmerise				
Rajoni	Qarku	Njvksh	Nr. Qendrave	%
TIRANË	Tiranë	Tiranë	34 / 36	94%
		Kavajë	9 / 10	90%
	Durrës	Durrës	20 / 20	100%
		Krujë	6 / 6	100%
	Dibër	Dibër	16 / 16	100%
		Mat	13 / 13	100%
		Bulqizë	9 / 9	100%
ELBASAN	Elbasan	Elbasan	27 / 27	100%
		Librazhd	11 / 11	100%
		Gramsh	8 / 8	100%
		Peqin	6 / 7	86%
	Korcë	Korçë	18 / 18	100%
		Pogradec	9 / 9	100%
		Devoll	6 / 6	100%
		Kolonjë	4 / 4	100%
	Berat	Berat	15 / 15	100%
		Kuçovë	4 / 4	100%
		Skrapar	7 / 7	100%
SHKODËR	Shkodër	Shkodër	19 / 19	100%
		M. Madhe	6 / 6	100%
		Pukë	11 / 11	100%

	Kukës	Kukës	11 / 14	79%
		Has	2 / 5	40%
		Tropojë	9 / 9	100%
	Lezhë	Lezhë	12 / 11	109%
		Kurbin	5 / 5	100%
		Mirditë	3 / 6	50%
VLOREË	Vlorë	Vlorë	21 / 21	100%
		Sarandë	8 / 9	89%
		Delvinë	5 / 5	100%
	Fier	Fier	20 / 20	100%
		Lushnjë	18 / 18	100%
		Mallakastër	7 / 9	78%
	Gjirokastër	Gjirokastër	21 / 21	100%
		Përmet	8 / 8	100%
		Tepelenë	7 / 7	100%
		TOTAL	415 / 430	96%

Tabela 2. Numri Total i Rasteve të Sindromave të Survejancës “Alert” në Javën 01



	JAVA 01
Diarre pa gjak	1236
Diarre me gjak	0
Inf. Resp. të sipërme	6972
Inf. Resp. të poshtme	3108
Rash me temperaturë	46
Verdhëza	0
Ethe e zgjatur e pashpjeguar (> 3 javë)	0
Anomali kongenitale	0
Konjuktivit akut te neonatët	0
Numri i Njësive Raportuese	415
% e Njësive Raportuese	96% (415/430)

Rash me temperaturë



Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog, rastet e mëposhtme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për variçelë:

Tiranë – 45 raste

Fier – 1 rast


Grafiku 1. Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas javëve**Grafiku 2. Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas grup-moshave**

Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme paraqet ulje në javën 01 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 52 të vitit 2025.

Grafiku 3. Trendi në kohë i Diarreve pa gjak sipas javëve**Grafiku 4. Shpërndarja e Diarreve pa gjak sipas grup-moshave**


Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet ulje në javën 01 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 52 të vitit 2025.

Grafiku 5. Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000




Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme paraqet ulje në javën 01 krahasuar me javën paraardhëse, java 52 duke mbetur brenda kufijve të aktivitetit sezonal normal e cila shpjegohet dhe me frekuentimin e ulët të institucioneve shëndetësore gjatë festave.

Grafiku 6. Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” në javët 45 – 01 të sezonit 2024-2025 dhe sezonit 2025-2026. Numri i rasteve.




Në javën 01 të vitit 2026 vërehet një ulje e numrit të Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme.

Grafiku 7. Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas grup-moshës. Incidenca (raste/10.000)




Grafiku 8. Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas NJVKSH në javën 52/2025 dhe 01/ 2026. Incidenca (raste/10.000).




Vërehet një rritje e infeksioneve respiratore sidomos në Vlorë dhe po ashtu në Gramsh dhe Tropojë që lidhet me përhapjen e gripit në vend.

Grafiku 9. Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët 52-01 të sezonit 2024-2025 dhe sezonit 2025-2026.
Numri i rasteve



Në javën 01 vërehet prirje në ulje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”, këtë vit vërehet një numër më i ulët i këtyre infeksioneve, krahasuar me një vit më parë.

Grafiku 10. Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH në javën 52/2025 dhe 01/2026. Incidenca (raste/10.000).



Vërehet rritje e diarreve sidomos në NJVKSH Lezhë ku situata po monitorohet .

Ngjarje ndërkombëtare

1. Kroaci – Salmonella Typhimurium rezistente ndaj antibiotikeve

Instituti i Shëndetit Publik i Kroacisë raporton 12 raste në njerëz (mosha 1–79 vjeç) me izolime të konfirmuara të Salmonella Typhimurium rezistente ndaj shumë antibiotikeve, të identifikuara nga fillimi i nëntorit deri në mesin e dhjetorit 2025.

Të gjitha rastet janë të lidhura gjeografikisht me një qark të vetëm në Kroacinë veriore. Është identifikuar një klaster i ri i Salmonella Typhimurium, sequence type ST19, që shfaq një model fenotipik të rezistencës ndaj shumë antibiotikëve, i shoqëruar me shënuesit përkatës gjenotipikë të rezistencës: blaTEM-1, blaDHA-1, sul1, tet(A), aph(3')-Ia, aph(3')-Ib, aph(6)-Id, dfrA19, tet(D), qnrB4, mcr-9. Të gjitha izolimet grupohen brenda 0–3 AD sipas analizës cgMLST. Nuk janë identifikuar izolime të lidhura ngushtë në vende të tjera si Irlanda, Franca, Norvegjia dhe Holanda.

2. Republika Çeke – Përditësim mbi shpërthimin e hepatitit A

Në vijim të shpërthimit të hepatitit A në Republikën Çeke, Ministria e Shëndetësisë raporton 3049 raste të hepatitit A në vend deri më 14 dhjetor 2025. Janë regjistruar 34 vdekje.

Numri i rasteve të raportuara në javët e fundit, duke filluar rreth javës kalendarike 45, ka treguar një tendencë në rënie. Rastet e hepatitit A të raportuara në vitin 2025 tejkalojnë ndjeshëm mesataren dhe vlerat maksimale të rasteve të raportuara gjatë periudhës 2018–2024.

Rastet janë raportuar në të gjitha grupmoshat, nga fëmijët më të vegjël deri te të moshuarit. Numri më i lartë i rasteve në vitin 2025 është raportuar në grupmoshën 35–39 vjeç, e ndjekur nga grupmoshat 40–44 vjeç, 30–34 vjeç dhe 45–49 vjeç.

Tek fëmijët, numri më i madh i rasteve është regjistruar në grupmoshën 5–9 vjeç. Hepatiti A është raportuar edhe në 14 fëmijë nën moshën 1 vjeç. Numri më i lartë i rasteve të hepatitit A në vitin 2025 është raportuar nga qyteti i Pragës (1303 raste), Rajoni i Bohemisë Qendrore (461 raste) dhe Rajoni Moravian-Silesian (243 raste). Nga gjithsej 3049 raste të raportuara në vitin 2025, 2350 persona janë shtruar në spital në repartet e sëmundjeve infektive (77.1%).